

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil,** Gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, duke vendosur sipas padisë së paditësit \_\_\_\_\_, nga f. \_\_\_\_\_ -Komuna e Gjilanit, te cilin e përfaqëson av. \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komonale për Arsim në Gjilan, të cilën e përfaqëson Mr.sc. \_\_\_\_\_, baza e kontestit, mardhënia e punës, e pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 27.07.2016, me dt. 27.09.2016, mori këtë:

### **AKTGJYKIM**

**I.REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit \_\_\_\_\_, nga fshati \_\_\_\_\_ Komuna e Gjilanit, me të cilën paditësi ka kërkuar, që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komonale e Arsimit në Gjilan, paditësin ta sistemojë në vendin e punës Zyrtar Administrativ pranë Shkollës Filllore " \_\_\_\_\_ " në fshatin \_\_\_\_\_, Komuna e Gjilanit, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.**

#### **Arsyetim**

Paditësi \_\_\_\_\_, nga fshati \_\_\_\_\_ Komuna e Gjilanit, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjilani- Drejtoria e Arsimit në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet Komuna e Gjilanit, që paditësin \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ ta sistemojë në vendin e punës, Zyrtar Administrativ pranë Shkollës Filllore " \_\_\_\_\_ " në fshatin \_\_\_\_\_; konform vendimit nr. \_\_\_\_\_ të dt.18.06.2010, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Përfaqësuesi i paditësit av. \_\_\_\_\_ në shqyrtimin kryesor të mbajtur më datën 27.07.2016, ka precizuar kërkesëpadinë e paditësit ashtu që ka tërhequr pjesën e padisë që ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave personale, kurse ka mbetur vetëm sa i përket kërkesëpadisë që të detyrohet Komuna e Gjilanit, që paditësin \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_, ta sistemojë në vendin e punës, Zyrtar Administrativ pranë Shkollës Filllore " \_\_\_\_\_ " në fshatin \_\_\_\_\_; konform vendimit nr. \_\_\_\_\_ të dt.18.06.2010, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës Komuna e Gjilanit, Mr.sc. \_\_\_\_\_, në përgjigjeje në padi si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet, pasi që lidhur me këtë konetest, Inspeksioni i Arsimit me Vendimin e saj nr. \_\_\_\_\_ të dt. 05.04.2016, ka dhënë përgjegjen e duhur sa i përketë pathemelësisë së kërkesës së paditësit.

Gjykata lidhur me këtë qështje juridike civile nuk ka pezulluar procedurën për 180 ditë, konform Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Pergjegjësitë, LIGJI NR. 03/L-048/ neni 68 lidhur me nenin 67, pasi që kërkesa e paditësit nuk është e shprehur në të holla, por në të drejta nga marrëdhënia e punës për sistemimin e tij në vendin e punës Zyrtar Administrativ pranë Shkollës Fillore " " në fshatin " " it-Komuna e Gjilanit.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë në këtë çështje juridiko - civile, gjykata bëri administrimin e provave materiale edhe ate: Përgjigjja e DKA në Gjilan e dt.17.12.2015, përgjigjja në kërkesën e dt.18.02.2016, vendimi 01 nr. dt.18.06.2010, ankesa e dt.14.04.2016, vendimi nr. i dt.05.04.2015, vërtetimi nr.prot. i dt.28.12.2015, certifikata me nr. referencë 493/0915 lëshuar në Prishtinë me datë 17.09.2015, vendimi DKA me nr. i dt.07.02.2015, kontrata e punës 05. Nr.685/2011 e dt.16.08.2011, kontrate punës në kohë të caktuar me nr.05 e dt.18.09.20009, kontrata e punës 05. Nr.598/08 e dt.03.09.2008, kontrata e punës me nr.505/2007-2008 me numër prot.10, kontrata e punës nr.408/2006, nr.prot.07, kontrata e punës nr.439/04-7, kontrata e punës me nr.893/03-87, kontrata për mësues të përkohshëm e dt/30.08.2000, shkresa e emërimit nr.0013878 e dt.30.08.2000 dhe dëgjimin e paditësit në cilësi të palës.

Paditësi nga fshati në cilësi të palës ka deklaruar: se ai kishte qenë drejtor i shkollës prej dt.16.08.2011 e deri më 16.08.2015, me kontratë të rregullt të punës. Para se ti kishte skaduar kontrata e punës në statusin e drejtorit ai kishte shkuar në DKA- në Gjilan dhe kishte biseduar me shefin e personelit për të ardhmen e tij pas përfundimit të mandatit si drejtor. Kërkesa e tij gojore kishte qenë se nëse nuk zgjidhet drejtor i shkollës të kthehet në vendin e punës, Zyrtar Administrativ pasi që atë punë e kishte kryer më herët edhe atë në mënyrë vullnetare dhe pas një bisede me shefin e personelit kishin ra në ujdë që të kthehet në vendin e punës zyrtar administrativ dhe shefi i personalit ka kërkuar nga ai që të bëjë një kërkesë me shkrim në lidhje me këtë vend pune-punëtor administrativ, çka të njëjtën edhe e kishte bërë me shkrim, ishte zyrtarizuar vendi i punës, dhe në vend tij e kishin sjellë një punëtor tjetër si zëvendësim, i cili ende vazhdon të punoj. I njëjti pastaj kishte deklaruar se ma rastin e kandidimit për postin e drejtorit në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës kishin qenë të obliguar që tia ruajnë vendin e mëparshëm të punës.

**Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8. të LPK-ës dhe në bazë të rezultatit të procedurës së zhvilluar kontestimore gjykata konstatoi këtë gjendje faktike:**

Se paditësi ka qenë punëtor i Shkollës Fillore " "në " " prej 15.11.1999 e deri më 07.12.2015, pra 11 vite e 1 muaj e 15 ditë mësimdhënës dhe 5 vite e 7 ditë, drejtor i shkollës, fakt ky që u vërtetua në bazë të vërtetimit të lëshuar nga sekretari i kësaj shkolle, pastaj nga Kontrata e Punës nr. 685/2011 e dt. 16.08.2011, në bazë të së cilës konfirmohet se paditësi ka qenë Drejtor i SHF „ „ në fsh. „ nga data 16.08.2011 e deri më dt. 16.08.2015, Kontrata e Punës në Kohë të Caktuar me nr. prot. 06/2010, në bazë të së cilës konstatohet se paditësi nga data

01.09.2008, e deri më dt. 31.12.2009, ka punuar si mësimdhënës, Kontrata e Punës me nr. prot. 07, me të cilën konstatohet se paditësi ka punuar si mësimdhënës në të njëjtën shkollë nga data 01.09.2006 e deri më dt. 31.08.2007, pastaj Kontrata e Punës me nr. 439/04-7, Kontrata e punës për mësimdhënës me nr. 893/03-87 Kontrata për Mësues të Përkohshëm e dt. 30.08.2000, Shkresë Emërimi i dt. 31.08.2000, në bazë të së cilave pamëdyshje konstatohet përvoja e punës së paditësit nga viti 2000 e deri në vitin 2015/ fakt i cili nuk ka qenë kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse/.

Më dt. 05.11.2015, është mbajtur intervista e kandidatëve për Drejtor të SHFMU „  
„ për fshatin \_\_\_\_\_, ku në mesin e kandidatëve ka qenë edhe paditësi, por se nga vlerësimi përfundimtar ka fituar kundërkandidati tjetër dhe për këtë DKA në Gjilan ka marrur vendim me nr. 05. 061-116285 të dt. 07.12.2015 me të cilin ka shpallur rezultatet e zgjedhjes së drejtorit për SH. F. „ \_\_\_\_\_, në DKA në Gjilan, më dt. 17.12.2015, ia ka dhënë një përgjegjëje paditësit duke theksuar se ai nuk i ka plotësuar kushtet e përgjithshme sipas normativit për Mësimdhënës nr. 8/2014 për Procedurat dhe Përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zv, Drejtorëve të IEAA-së / neni 3.3 paragraf. 1 nënparagraf. 1.2.

Në kërkesën e paditësit për ruajtjen e vendit të punës konform Vendimit të Komunës së Gjilanit nr. 01. 7289 të dt. 18.06.2010, DKA-ja në Gjilan, më dt. 18.02.2016, e ka njoftuar paditësin se Udhëzimi Administrativ i MASHT-it nr.8/2014, i dt. 25.02.2014, respektivisht neni 9 i tij nuk ka fuqi retroaktive, por ky Udhëzim Administrativ zbatohet vetëm për ata kandidatë të ardhshëm që zgjedhën sipas këtij udhëzimi dhe ruajtja e vendit të punës ka të bëjë me pozita të mësimdhënësve ku nëpunësi mëparë ka qenë i punësuar, prandaj duke marrur parasysh kualifikimin e paditësit DKA-ja nuk ka mundur ta sistemojë në ndonjë vend pune për mësimdhënës, kurse vendet e punës si sekretar shkolle apo Zyrtar Administrativ janë pozita të shërbyesve civil që rregullohen me Ligjin nr.03/L-149 për Shërbyesit Civil i Republikës së Kosovës, pra administrohen nga Zyra e Kryetarit të Komunës.

MAPL me dt. 13.01.2014 dhe me numër të shkresës 02004-10, iu ka drejtuar Kryetarit të Komunës së Gjilanit, duke ia rikujtuar Kryetarit të Komunës së Kuvendi i Komunës nuk ka mandat ligjor të nxjerrë vendime për ruajtjen e vendeve të punës së drejtorëve të drejtorive që janë pjese e administratës Komunale të caktuar nga Kryetari i Komunës si dhe për nëpunësit civil të Administratës Komunale që njihërit janë zgjedhur anetarë të Kuvendit të Komunës.

Po ashtu në bazë të kësaj shkresë MAPL ia ka rikujtuar kryetarit edhe autorizimet dhe kompetencat që ka lidhur me ruajtjen e vendeve të punës së drejtorëve, prandaj, edhe e ka vlerësuar se vendimet e nxjerra nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, janë jashtë mandatit ligjor të Kuvendit si dhe janë nxjerre në kohen kur ligji nr. 03/L-149 për Shërbyesit Civil i Republikës së Kosovës nuk ka qenë në fuqi.

Po ashtu edhe Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm-Departamenti i Inspeksionit me Vendimin nr. 10/172 të dt. 05.04.2016, ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar me ligj pasi që paditësi nuk i ka plotësuar edhe kushtet e përgjithshme të konkursit, meqë ai ka të kryer Fakultetin e Ekonomik -BprAL „ \_\_\_\_\_, dhe për këtë vend pune konsiderohet i pakualifikuar.


Gjykata pas analizimit dhe shtjellimit të shkresat të lëndës e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, përkthimin në vendin e punës si zyrtar administrative, ngase i njëjti më parë ka qenë i punësuar si mësimdhënës statusi i të cilit është rregulluar sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212,, kurse vendi i punës për të cilën pretendon paditësi se duhet të sistemohet është pozitë e rregulluar Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji 03/L-149 dhe i cili vend pune administrohet nga Zyra e kryetarit të Komunës, prandaj edhe nuk mund të sistemohet në këtë pozitë.

Gjykata me rastin e konstatimit të gjendjes faktike besimin ia shprehu provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të shtjelluara në seancën kryesore edhe ate: përgjegjëja e DKA në Gjilan e dt.17.12.2015, përgjigja në kërkesën e dt.18.02.2016, vendimi 01 nr.7289 i dt.18.06.2010, ankesa e dt.14.04.2016, vendimi nr.10/172 i dt.05.04.2015, vërtetimi nr.prot.120/2015 i dt.28.12.2015,qertifikata me nr.referencë 493/0915 lëshuar në Prishtinë me datë 17.09.2015,vendimi DKA me ndr.061-116285 i dt.07.02.2015, kontrata e punës 05. Nr.685/2011 e dt.16.08.2011, kontrate punës në kohë të caktuar me nr.05 e dt.19.09.20009, kontrata e punës 05. Nr.598/08 e dt.03.09.2008, kontrata e punës me nr.505/2007-2008 me numër prot.10, kontrata e punës nr.408/2006, nr.prot.07, kontrata e punës nr.439/04-7, kontrata e punës me nr.893/03-87,

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marur në bazë të nenit 452 par.4. të LPK-ës, pasi që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet gjyqësore edhe pse në tërësi ka pasur sukses në kundërshtimin e pretendimeve të paditësit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 143 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykatësi,  
Mr.sc.lur.Berat Spahiu



**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

